




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



RREGULLORE PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE NË KOMUNËN E FUSHË-KOSOVËS

E MIRATUAR MË DATË: 15.10.2008

Në bazë të dispozitave të nenit 7 të Ligjit Për Përdorimin e Gjuhëve Nr. 02/L-37, nenit 9 të Ligjit Për Vetësqeverisjen Lokale Nr. 03/L-40 dhe nenit 8 të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës, Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 15.10.2008, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE NË KOMUNËN E FUSHË-KOSOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo Rregullore ka për qëllim që të sigurojë përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet dhe ndërmarrjet komunale të Komunës së Fushë-Kosovës.

Neni 2

Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe, si gjuhë zyrtare në Kosovë, kanë status të barabartë sa i përket përdorimit të tyre në të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet Komunale të Komunës së Fushë-Kosovës.

Neni 3

- 3.1 Gjuhët zyrtare përdoren në baza të barabarta në takimet dhe punën e organeve ekzekutive dhe legjislative komunale.
- 3.2 Institucionet komunale do të mundësojnë përkthimin nga një gjuhë zyrtare në tjetrën, nëse kjo kërkohet në takimet zyrtare dhe takime publike të organizuara nga Komuna.

Neni 4

- 4.1 Çdo person ka të drejtë të komunikoj dhe të pranoj shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga institucionet komunale të komunës së Fushë-Kosovës dhe nga zyrtarët në cilëndo gjuhë zyrtare.
- 4.2 Të gjitha institucionet e komunës kanë për obligim të sigurojnë që çdo qytetarë të mund të komunikojë dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet publike nga institucionet komunale në cilëndo gjuhë zyrtare.

Neni 5

- 5.1 Gjuhët zyrtare në Komunën e Fushë-Kosovës përdoren në baza të barabarta në takimet dhe punën e organeve legjislative dhe ekzekutive të Komunës.
- 5.2 Administrata dhe institucionet komunale mundësojnë përkthimin nga një gjuhë zyrtare në tjetrën, nëse kërkohet përkthimi në takimet e tyre si dhe në takimet publike të organizuara nga Komuna.

Neni 6

Procesverbalet nga takimet dhe shënimet tjera zyrtare të Kuvendit të Komunës si dhe dokumentet tjera të organeve ekzekutive dhe administrative të komunës mbahen dhe lëshohen në gjuhët zyrtare të Komunës.

Neni 7

Të gjitha Rregulloret dhe Aktet e miratuara nga institucionet komunale nxirren dhe publikohen në gjuhët zyrtare të Komunës.

Neni 8

- 8.1 Qytetarët të cilët u takojnë komuniteteve, gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar, kanë të drejtë të paraqesin të gjitha kërkesat dhe dokumentet tjera në formë të shkruar, apo gojore, me të cilat u drejtohen organeve të Komunës në gjuhën e tyre.
- 8.2 Organet komunale janë të obliguara që qytetarëve, gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar, në kërkesat e tyre të shkruara apo gojore, t'u përgjigjen në gjuhën e tyre, nëse ata kërkojnë.

Neni 9

- 9.1 Qytetarët, gjuha amëtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare gjatë punës dhe në takimet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij, si dhe në takimet e tjera të organizuara nga Komuna, kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre në këto takime.
- 9.2 Të gjitha dokumentet e dorëzuara nga anëtari, gjuha amëtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare, duhen të përkthehen në gjuhë zyrtare si dhe të gjitha përgjigjet e kërkuara do t'i ipen në gjuhën e tij.

Neni 10

- 10.1 Emrat zyrtar të institucioneve dhe organeve komunale paraqiten në gjuhët zyrtare në përdorim në Komunë.
- 10.2 Shenjat zyrtare që shënojnë dhe përfshijnë emrin e komunës, fshatrave, rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike, paraqiten edhe në gjuhën e komuniteteve gjuha e të cilave ka statusin e gjuhës zyrtare në Komunë.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 11

Kjo Rregullore mund të ndryshohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit.

Neni 12

Në rast të mos-harmionizimit ndërmjet dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve mbizotrojnë dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Neni 13

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS
Nr.219 Data 15.10.2008

